


Përfshirja e Parimeve të RAP në Politikat Sektoriale

Raporti për Kosovën

INPO | Prishtinë | Gusht, 2024



FUSHA E RAP: Menaxhimi i Financave Publike – Prokurimi Publik

INSTITUTUCIONI: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

SEKTORI I POLITIKAVE: Sektori i Prokurorimit

Përmbajta

Përmbledhja e raportit / 3

I. Hyrje / 4

I.1 Çfarë monitoron WeBER dhe si? / 4

I.2 Në këtë raport / 4

III. Analizë / 5

Kërkesa 1: Planet e përditësuara të prokurimit publik janë të disponueshme publikisht / 5

Kërkesa 2: Prokurimet Publike Nisen në përputhje me Planin / 5

Kërkesa 3: Ndryshimet në planet e prokurimit publik janë qartësisht të dukshme / 7

Kërkesa 4: Ndryshimet në planet e prokurimit publik justifikohen qartë / 7

Kërkesa 5: Autoriteti Kontraktues kryen Procedura të Hapura/Konkurruese të Prokurimit Publik / 7

Kërkesa 6: Numri mesatar i ofertuesve në procedurat e hapura/konkurruese / 8

Kërkesa 7: Raportet vjetore që përfshijnë të gjitha prokurimet publike të kryera janë në dispozicion të publikut / 9

III. Rekomandime për përmirësime / 10

Shtojcat / 11

Autor: INPO

Botuesi: Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Fusha e RAP: Menaxhimi i Financave Publike – Prokurimi Publik

Institucioni: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Spektori i Politikave: Spektori i prokurimit

Prishtinë | Gusht, 2024



Funded by
the European Union



Austrian
Development
Agency

I prodhuar në kuadër të projektit "Western Balkan Enablers for Reforming Public Administrations – WeBER 3.0", i cili zbatohet nga rrjeti Think for Europe Network – TEN dhe Qendra për Kërkime në Administratën Publike – KDZ. WeBER 3.0 financohet nga Bashkimi Evropian dhe Agjencia Austriake për Zhvillim – ADA.

Një ndër anëtarët e Platformës WeBER 3.0 për monitorimin e reformës në administratën publike nga Kosova janë Inicativat Qytetare. Pikëpamjet dhe opinionet e paraqitura në këtë dokument janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo ADA. As Bashkimi Evropian, ADA, TEN apo KDZ nuk mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e tij.

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni: www.par-monitor.org.

Përmbledhja e raportit

Kjo përmbledhje ofron një pasqyrë të rezultateve të monitorimit të aktiviteteve të prokurimit publik të Ministrisë së Infrastrukturës, duke vlerësuar pajtueshmërinë me legjislacionin e prokurimit publik në Kosovë. Analiza nxjerr në pah si pajtueshmërinë ashtu edhe mangësitë në fushat kryesore, duke përfshirë publikimin dhe zbatimin e planeve të prokurimit, përdorimin e procedurave konkurruese dhe transparencën e raportimit.

Ky raport është përgatitur me përdorimin e disa metodave, duke filluar me analizimin e planifikimit të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2023 dhe 2024. Të dhënat u mbledhën nga platforma e prokurimit publik për të shqyrtuar aktivitetet e prokurimit me fokus në llojet e procedurave të përdorura dhe numrin e ofertuesve të përfshirë. Analiza kuantitative është përdorur për të llogaritur përqindjet e procedurave konkurruese kundrejt atyre jokonkurruese, ndërsa analiza krahasuese ka identifikuar mospërputhje ndërmjet planifikimit të prokurimit dhe fillimit të aktiviteteve të prokurimit. Për të fituar njohuri mbi sfidat e përafrimit të aktiviteteve të prokurimit me planin, u zhvillua një intervistë me zyrtarin kryesor të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës.

Ministria ka përmbushur kërkesën ligjore për të publikuar planin e saj të prokurimit për vitin 2024, me planin e disponueshëm në platformën e prokurimit elektronik dhe faqen zyrtare të Ministrisë që nga 19 janari 2024. Nuk janë bërë përditësime apo ndryshime në planin e prokurimit, duke reflektuar pajtueshmërinë me rregulloret. Megjithatë, ministria ka hasur në vështirësi për ti inicuar aktivitetet e saj të prokurimit me afatet e planifikuara. Ndër pesë aktivitetet e fundit të planifikuara, vetëm një është inicuar dhe ka filluar përpara afatit, ndërsa katër të tjerat nuk janë inicuar deri në fund të gushtit 2024 për shkak të vonesave në realizimin e projektve nga njësitë kërkuuese. Kjo mospërputhje tregon për një hendek të madh midis planifikimit dhe ekzekutimit.

Ministria nuk ka ndryshuar planet e saj të prokurimit në vitet 2024 apo 2023, duke e bërë të pamundur vlerësimin e justifikimeve për ndryshimet në planifikim. Megjithatë, mungesa e ndryshimeve jep indikacione për mungesë të menaxhimit të përshtatshëm në përgjigje të rrethanave Nga 126 aktivitete të prokurimit të inicuar në vitin 2023 dhe 2024, 59.52% janë realizuar përmes procedurave konkurruese, ndërsa 40.48% ishin jokonkurruese, duke përfshirë 25 aneks kontrata. Mbështetja e lartë në procedurat jokonkurruese tregon nevojën për të përmirësuar qasjen e ministrisë për të nxitur konkurrencën dhe transparencën.

Numri mesatar i ofertuesve në procedurat konkurruese ishte 5.69, i cili, megjithëse i arsyeshëm, ishte pak më i ulët se pragu i dëshiruar, gjë që tregon për numër të kufizuar ofertuesish dhe nevojën për pjesëmarrje më të gjerë në proceset e prokurimit. Një çështje kritike e identifikuar ishte mungesa e raporteve vjetore të disponueshme për publikun për kontratat e nënshkruara për vitin 2023, pasi ministria nuk i publikoi këto raporte edhe pse ato ishin dorëzuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik. Ky lëshim dëmton transparencën dhe ulë besimin e publikut.

Në përgjithësi, Ministria e Infrastrukturës tregon pajtueshmëri në disa aspekte ligjore të prokurimit publik, por kërkohen përmirësime të rëndësishme në zbatim, transparencë dhe konkurrencë. Forcimi i koordinimit të brendshëm, përmirësimi i qasjes në të dhënat e prokurimit dhe promovimi i konkurrencës më të gjerë janë hapa thelbësorë për përafrimin e praktikave të ministrisë me standardet më të mira të prokurimit dhe për të siguruar shpenzime publike më të përgjegjshme dhe efikase.

Rekomandimet fokusohen në rritjen e transparencës, efikasitetit dhe përdorimit të procedurave konkurruese të proceseve të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës. Rekomandohet që ministria të publikojë planet e saj të prokurimit dhe raportet vjetore për kontratat e nënshkruara në faqen e saj zyrtare dhe për të përmirësuar qasjen e publikut dhe llogaridhënien. Për më tepër, ministria duhet të sigurojë që afatet e prokurimit të përputhen me nevojat e njësitë kërkuuese për të shmangur vonesat dhe për të rritur efikasitetin e përgjithshëm. Dhënia e justifikimeve për aktivitetet e paplanifikuara të prokurimit do të rrisë transparencën dhe do të ruajë integritetin e procesit. Për më tepër, rritja e përdorimit të procedurave konkurruese dhe rritja e numrit mesatar të ofertuesve për procedurë do të nxisë konkurrencë më të madhe, do të përmirësojë cilësinë dhe do të ndihmojë në arritjen e çmimeve më të mira. Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të forcojë praktikën e prokurimit, do të sigurojë përputhjen me standardet ligjore dhe do të krijojë besim më të madh publik në aktivitetet e prokurimit të ministrisë.

I. Hyrje

I.1 Çfarë monitoron WeBER dhe si?

Monitorimi i praktikave të prokurimit publik, brenda fushës së Menaxhimit të Financave Publike (MFP), kryhet në përputhje me Parimin 29 të SIGMA.

Parimi 29 Autoritetet kontraktuese kryejnë operacione të prokurimit publik, duke përfshirë partneritetin publiko-privat, në mënyrë efikase dhe ekonomike.

Lista e kontrollit e MFP-së për prokurimin publik përbëhet nga 7 kërkesa që kanë të bëjnë me transparencën dhe konkurrencën e praktikave të prokurimit publik të autoritetit kontraktues të vlerësuar. Së pari, kërkesat përqendrohen në planifikimin e prokurimit publik – disponueshmërinë e planeve të përditësuara, si dhe transparencën dhe justifikimin e ndryshimeve të tyre. Gjithashtu, monitorohet nëse këto plane respektohen në drejtim të nisjes së procedurave të prokurimit publik sipas planifikimit (bazuar në një mostër). Së dyti, konkurrenca dhe transparenca e prokurimit publik monitorohet duke vlerësuar se sa të hapura janë këto procedura për furnitorët e interesuar, d.m.th nëse metodat e hapura dhe konkurruese të prokurimit përbëjnë opsionet më të përdorura në praktikë dhe cili është numri mesatar i ofertuesve që përdorin këto metoda brenda periudhës së monitorimit. Së fundi, kërkesa e fundit shqyrton nëse ka një praktikë transparente dhe gjithëpërfshirëse të raportimit vjetor, që përfshin të gjitha prokurimet publike të kryera, të planifikuara apo gjatë një viti kalendarik.

Për mbledhjen e të dhënave, qasja në këtë listë kontrolli mbështetet në rishikimin e faqeve zyrtare të autoritetit kontraktues të vlerësuar, portalit të prokurimit publik të sponsorizuar nga qeveria, por edhe në paraqitjen e kërkesave për qasje informacione dokumente zyrtare për të gjitha dokumentet që nuk janë të disponueshme online. Në varësi të kërkesave individuale, periudha e analizës mbulon praktikën e prokurimit publik për vitin në vazhdim në kohën e vlerësimit, ose vitin e kaluar kalendarik, ose të dyja.

I.2 Në këtë raport

Në këtë raport, Seksioni II thellohet në një analizë të detajuar të secilës kërkesë që ka të bëjë me proceset dhe praktikën e prokurimit brenda Ministrisë së Infrastrukturës. Ky seksion shqyrton sistematikisht respektimin e kriterëve të përcaktuara nga ministria, duke vlerësuar aspekte të tilla si publikimi i planeve të përditësuara të prokurimit, fillimi i aktiviteteve të prokurimit në përputhje me afatet kohore të përcaktuara dhe transparenca e ndryshimeve të bëra në planet e prokurimit.

Seksioni II vlerëson gjithashtu respektimin e procedurave konkurruese dhe numrin mesatar të ofertuesve që marrin pjesë në këto procese, duke nxjerr në pah çdo mospërputhje ose shkelje të vërejtur. Çdo kërkesë përdoret për të përcaktuar nivelin e përputhshmërisë me standardet ligjore dhe procedurale, duke ofruar një kuptim gjithëpërfshirës të performancës së ministrisë në këto fusha.

Nga ana tjetër, Seksioni III, ofron rekomandime të përshtatura bazuar në gjetjet e paraqitura në Seksionin II. Ky seksion përshkruan hapat e veprimit që Ministria e Infrastrukturës duhet të ndërmarrë për të adresuar mangësitë e identifikuara dhe për të rritur efikasitetin dhe transparencën e përgjithshme të praktikave të saj të prokurimit. Rekomandimet fokusohen në përmirësimin e qasjes së publikut në planet e prokurimit, sigurimin e fillimit në kohë të aktiviteteve të planifikuara, justifikimin e aktiviteteve të paplanifikuara të prokurimit, rritjen e përdorimit të procedurave konkurruese dhe rritjen e numrit mesatar të ofertuesve në proceset e prokurimit.

Për më tepër, ai thekson rëndësinë e publikimit të raporteve vjetore për kontratat publike të nënshkruara për të rritur llogaridhënien. Ky seksion synon të ofrojë udhëzime të qarta dhe praktike për të lehtësuar përmirësimet dhe për të harmonizuar praktikën e prokurimit të ministrisë me praktikën më të mira dhe kërkesat rregullatore.

II. Analizë

Seksioni II i këtij raporti thellohet në analizën e praktikave të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës, duke u fokusuar në pajtueshmërinë me kërkesat specifike. Ai vlerëson disponueshmërinë dhe saktësinë e planeve të prokurimit, respektimin e afateve kohore të fillimit, qartësinë e ndryshimeve, aplikimin e procedurave konkurruese dhe numrin mesatar të ofertuesve. Kjo analizë synon të vlerësojë respektimin e standardeve ligjore dhe procedurale nga ministria dhe të identifikojë fushat kryesore për përmirësim.

Kërkesa 1: Planet e Përditësuara të Prokurimit Publik janë të Disponueshme Publikisht

Kjo kërkesë vlerëson nëse autoriteti kontraktues, Ministria e Infrastrukturës, i bën të disponueshme për publikun planet e saj aktuale të prokurimit publik (PP) për vitin kalendarik në vazhdim, qoftë përmes faqes së saj zyrtare ose përmes portalit të prokurimit elektronik. Sipas legjislacionit të prokurimit publik në Kosovë, çdo institucion (autoriteti kontraktues) është i obliguar të përgatisë dhe publikojë planin e tij të prokurimit (Formulari B01 - Planifikimi i Prokurimit) për vitin vijues brenda 15 ditëve pas miratimit të buxhetit të vitit fiskal nga Kuvendi i Kosovës¹. Ky dokument duhet të dorëzohet gjithashtu në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP) për të verifikuar që planifikimi i prokurimit nuk përfshin aktivitete që janë në domenin e AQP-së. INPO paraqiti një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës duke kërkuar konfirmim për ndryshimet e mundshme në Planin e Prokurimit 2024. Në përgjigjen e saj zyrtare të marrë më 10 shtator 2024, Ministria e Infrastrukturës konfirmoi se nuk është bërë asnjë ndryshim në Planin e Prokurimit 2024.

Bazuar në hulumtimin e bërë në faqen zyrtare të ministrisë, platformën e prokurimit elektronik dhe kërkesën për qasje në dokumente zyrtare dërguar ministrisë, u konfirmua se ministria ka përbushur plotësisht kërkesën për të publikuar versionin më të fundit të planit të saj të prokurimit për vitin 2024. Plani i prokurimit është publikuar në platformën e prokurimit elektronik më 19 janar 2024, duke përbushur këtë kërkesë. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se Ministria e Infrastrukturës nuk e ka përditësuar apo modifikuar planin e prokurimit që nga publikimi fillestar i tij në fillim të vitit.

Kërkesa 2: Prokurimet Publike Nisen në Përputhje me Planin

Kjo kërkesë ka analizuar pesë aktivitetet e fundit të planifikuara në planin aktual të prokurimit për të përcaktuar nëse ato janë iniciuar brenda afateve të përcaktuara. Nga 5 aktivitetet e prokurimit të planifikuara në planin e prokurimit, vetëm dy aktivitete janë planifikuar të iniciohen pas datës 31 gusht; të gjitha aktivitetet e tjera duhej të kishin filluar deri në kohën kur INPO kishte përfunduar mbledhjen e të dhënave më 31 gusht. INPO identifikoi këto aktivitete dhe analizoi nëse ato ishin nisur sipas planit. Duke qenë se më shumë se pesë aktivitete kishin të njëjtën datë të parashikuar të inicimit, INPO analizozi pesë aktivitetet e fundit të planifikuara të përzgjedhura nga lista më afërt me datën 31 gusht.

¹ Neni 8, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Mund të qaset përmes <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

Përshkrimi i kontratës	Data e planifikuar për fillimin e prokurimit	Data aktuale e fillimit	Justifikimi i Ministrisë së Infrastrukturës	Vlerësimi i INPO-së mbi justifikimin
Furnizimi me ADE Blue për Automjete 4x4	01.08.2024	25.04.2024	Asnjë arsytim nuk është dhënë.	E pajustificuar.
Ndërtimi i rrugës Korishë - Kabash - Lidhja me Rrugën Rajonale R118	01.07.2024	Ende nuk është iniciuar	Vonesat për shkak të zhvillimit të projektit ekzekutiv dhe nevojiten shpronësime.	Justifikuar siç duhet.
Zbatimi i Takografit Digjital	03.06.2024	Ende nuk është iniciuar	Në pritje të përgjigjes nga njësia kërkuese.	E pajustificuar.
Zgjerimi i Rrugës Rajonale R102 Komoran – Skenderaj	03.06.2024	Ende nuk është iniciuar	Kërkesa e Komunës së Glogovcit për modifikimin e projektit.	Justifikuar siç duhet.
Rehabilitimi i Rrugës Kombëtare N9, segmenti Pejë – Kuqishtë - Qakorr	03.06.2024	Ende nuk është iniciuar	Vonesat për shkak të skadimit të kontratës së kompanisë së zhvillimit të projektit.	Justifikuar siç duhet.

Për të marrë arsytetime shtesë lidhur me arsyen e vonesës së procedurave, INPO ka dorëzuar kërkesë për qasje në dokumente zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës. Në përgjigjen e pranuar më 10 shtator 2024, ministria ka dhënë arsyetimin për katër nga pesë procedurat e prokurimit. Më poshtë është paraqitur një vlerësim i arsytimeve të dhëna nga ministria në përgjigjen e saj ndaj kërkesës për qasje në dokumente zyrtare:

Procedurat e prokurimit dhe arsytimet e ministrisë

1. Aktiviteti: Furnizimi me "ADE Blue për Automjete 4x4"

Ministria e Infrastrukturës nuk ka dhënë asnjë arsytim për fillimin e këtij aktiviteti të prokurimit tre muaj më herët se data e paraparë në planin e prokurimit. Prandaj, INPO vlerëson se fillimi i hershëm i këtij aktiviteti është i pajustificuar.

2. Aktiviteti: Ndërtimi i rrugës Korishë-Kabash, Lidhja me rrugën regjionale R118

Sipas Zyrës së Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës, vonesa në fillimin e këtij projekti siç ishte planifikuar ka ardhur për shkak të nevojës për përmirësime në hartimin e projektit dhe çështjeve që kanë të bëjnë me elaboratet e shpronësimit. Duke marrë parasysh sfidat e shpeshta të shpronësimit në projektet e infrastrukturës rrugore në Kosovë dhe faktin se kjo rrugë synohet të kalojë nëpër zona malore që kërkojnë zgjerim, INPO e konsideron të arsyetuar vonesën në fillimin e këtij aktiviteti.

3. Aktiviteti: Zbatimi i Takografëve Digjital

Zyra e Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës nuk ka marrë asnjë përgjigje nga njësia kërkuese për këtë aktivitet. Prandaj, INPO e konsideron të pajustificuar vonesën në fillimin e këtij aktiviteti.

4. Aktiviteti: Zgjerimi i Rrugës Rajonale R102, Komoran – Skenderaj

Sipas Zyrës së Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës, vonesa në inicim, sipas afatit kohor të paraparë, ka ardhur për shkak të negociatave të vazhdueshme me Komunën e Glogovcit lidhur me trasenë e re rrugore apo zgjerimin e asaj ekzistuese. Prandaj, INPO e konsideron të justifikuar vonesën në fillimin e këtij aktiviteti.

5. Aktiviteti: Rehabilitimi i Rrugës Kombëtare N9, segmenti Pejë - Kuqishtë - Qakorr

Sipas Zyrës së Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës, vonesa në inicim ka ardhur për shkak të skadimit të kontratës me kompaninë projektuese përgjegjëse për përgatitjen e projektit. Duke qenë se Ministria e Infrastrukturës, pas përfundimit të kontratës, filloi menjëherë procedurat për kontraktimin e një operatori të ri ekonomik për hartimin e projektit, INPO vlerëson se vonesa në fillimin e këtij aktiviteti është e arsyetuar siç duhet.

Duke marrë parasysh arsyetimet e dhëna nga autoriteti kontraktues, vetëm 3 nga 5 procedura të prokurimit të pa iniciuara sipas planit të PP-së janë arsyetuar në mënyrë të duhur dhe transparente. Prandaj, këto gjetje tregojnë se kjo kërkesë është përbushur pjesërisht nga Ministria e Infrastrukturës.

Kërkesa 3: Ndryshimet në planet e prokurimit publik janë qartësisht të dukshme

Kërkesa 3 vlerëson nëse ka pasur ndonjë ndryshim në planet e prokurimit të ministrisë në dy vitet kalendarike të fundit dhe nëse të gjitha ndryshimet janë qartë të dukshme në krahasim me planin origjinal të prokurimit për vitin përkatës. Sipas legjislacionit të prokurimit publik, Plani Përfundimtar i Prokurimit, pasi dorëzohet në AQP dhe publikohet në platformën elektronike, nuk mund të ndryshohet nëse një aktivitet i planifikuar i prokurimit nuk i nënshtrohet rishikimit të buxhetit.

Për të verifikuar nëse janë bërë ndryshime nga Ministria e Infrastrukturës në planet e prokurimit për vitin 2023 dhe 2024, INPO analizoi të dhënat e publikuara në seksionin "Planet e Prokurimit" në platformën elektronike të prokurimit. Të dhënat e publikuara tregojnë se nuk ka pasur ndryshime në planet e prokurimit. Mirëpo, për ta konfirmuar këtë, INPO ka dërguar pyetje në Zyrën e Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës. Në përgjigjet e marra nga Zyra për Informim më 18 korrik 2024 dhe 10 shtator 2024, është konfirmuar se nuk ka pasur ndryshime në planet e prokurimit për vitin 2023 dhe 2024. Prandaj, bazuar në rishikimin e INPO-s në platformën elektronike të prokurimit për të hulumtuar mundësin e ndonjë ndryshimi krahasuar me planin origjinal të PP-së, si dhe përgjigjet nga Ministria, konkludohet se Ministria nuk ka bërë asnjë ndryshim në planin e PP-së. Përfundimisht, sipas udhëzimit të vlerësimit thuhet se në rastet kur nuk janë bërë ndryshime, kërkesa konsiderohet e plotësuar plotësisht nga autoriteti kontraktues. Prandaj, **Ministria konsiderohet se e ka përbushur plotësisht Kërkesën 3.**

Kërkesa 4: Ndryshimet në Planet e Prokurimit Publik Justifikohen Qartë

Kërkesa 4 synon të vlerësojë nëse janë të justifikuara ndryshimet apo shtesat në planet e prokurimit për vitin aktual dhe atë të mëparshëm. Bazuar në gjetjet nga Kërkesa nr. 3, e cila vërtetoi se planet e prokurimit 2023 dhe 2024 nuk kanë pësuar asnjë ndryshim, nuk është e mundur të vlerësohen arsyetimet për ndryshime në këto plane. Sipas udhëzimit të vlerësimit të kërkesës 4, ku thuhet se nëse nuk janë bërë ndryshime, kërkesa konsiderohet e plotësuar plotësisht, prandaj **Ministria e Infrastrukturës konsiderohet se e ka përbushur plotësisht këtë kërkesë.**

Kërkesa 5: Autoriteti Kontraktues Zhvillon Procedura të Hapura / Konkurruese të Prokurimit Publik

Kërkesa 5 vlerëson nëse Autoriteti Kontraktues, Ministria, ka zhvilluar procedura të hapura dhe konkurruese të prokurimit për vitin 2022 dhe 2023. Sipas udhëzimeve të vlerësimit, aktivitetet e prokurimit të kryera në lote janë trajtuar si një procedurë e vetme.

Ligji i Prokurimit Publik në Kosovë përcakton gjashtë lloje të procedurave të prokurimit sipas të cilave mund të iniciohen aktivitetet e prokurimit. Metodatat që lejojnë procedurën e hapur dhe konkurruese përfshijnë:

Procedurat e hapura (neni 33, paragrafi 1): Çdo operator ekonomik mund të paraqesë ofertë dhe çdo operator ekonomik i interesuar ka mundësi të konkurrojë.

Procedurat e kufizuara (Neni 33, paragrafi 2): Autoriteti kontraktues fton operatorët ekonomikë që kanë kaluar fazën e përzgjedhjes të dorëzimeve ofertat.

Procedurat e Negociuara Konkurruese (neni 34): Autoriteti kontraktues negocion me operatorët ekonomikë për të përmirësuar ofertat e tyre pas paraqitjeve fillestare.

Procedurat e kuotimit të çmimeve (neni 36): Edhe pse të kufizuara dhe për kontrata me vlerë më të ulët, këto procedura përfshijnë konkurrencë ndërmjet operatorëve ekonomikë që ofrojnë çmime për të fituar kontratën.

Procedurat për kontratat me vlerë minimale (neni 37): Autoriteti kontraktues duhet t'u dërgojë ftesa të paktën tre operatorëve ekonomikë përmes sistemit elektronik të prokurimit.

Metodat që nuk lejojnë procedurën e hapur dhe konkurruese përfshijnë:

Procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit për kontratë (neni 35): Autoriteti kontraktues negociacion drejtpërdrejt me një ose më shumë operatorë ekonomikë pa thirrje të hapur për oferta.

Kontratat publike kornizë (neni 38): Në disa raste, konkurrenca është e kufizuar në mini-tenderë gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

INPO analizoi të gjitha aktivitetet e prokurimit të nisura nga janari 2023 deri në periudhën aktuale të monitorimit që përfundon më 31 gusht 2024.

Gjetjet e Procedurave Konkurruese:

Lloji i Procedurës	Numri i Aktiviteteve të Prokurimit
Procedurë e hapur	59
Procedurë e kufizuar	11
Procedurë e negociimit konkurrues	0
Procedurat e kuotimit të çmimeve	0
Procedurat e kontratës me vlerë minimale	5
Total	75

Në total janë iniciuar 75 aktivitete përmes procedurave konkurruese.

Gjetjet e Procedurave - Jo-konkurruese:

Lloji i Procedurës	Numri i Aktiviteteve të Prokurimit
Procedurat e negociuara pa njoftim kontrate	51
Kontratat publike kornizë	0
Total	51

Në përgjithësi, nga 126 aktivitete të iniciuara gjatë periudhës së monitorimit, 75 aktivitete (59.52%) janë iniciuar përmes procedurave konkurruese, ndërsa 51 aktivitete (40.48%) janë iniciuar përmes procedurave jokonkurruese.

Sipas udhëzuesit të vlerësimit për Kërkesën 5, nëse procedurat konkurruese zbatohen në më shumë se 50% por më pak se 85% të procedurave të prokurimit, **Ministria e Infrastrukturës e përbush pjesërisht këtë kërkesë.**

INPO ka analizuar edhe aktivitetet e nisura përmes procedurave jokonkurruese. Nga 51 procedura jokonkurruese, 25 janë kontrata aneks ose kontrata pune shtesë me kontratë bazë para-ekzistuese. Neni 35 i Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës lejon aktivitete të tilla vetëm për mbulimin e një ose më shumë kontratave për shërbime ose punë shtesë që, të vetme ose së bashku, nuk e kalojnë dhjetë përqind (10%) të vlerës së kontratës fillestare.

Kërkesa 6: Numri Mesatar i ofertuesve në Procedurat e Hapura/Konkurruese

Kërkesa 6 është verifikuar përmes vlerësimit të numrit total të ofertuesve që kanë dorëzuar oferta për secilën procedurë konkurruese për të përcaktuar numrin mesatar të ofertuesve për secilën procedurë të nisur. Duke qenë se disa aktivitete të prokurimit janë iniciuar si aktivitet i vetëm, por rezultojnë me kontrata të shumta për shkak të ndarjes së aktivitetit në lote, INPO ka analizuar numrin e ofertuesve për secilin lot.

Bazuar në gjetjet e mësipërme, nga 75 aktivitetet e inicuar përmes procedurave konkurruese në vitet 2024 dhe 2023:

53 aktivitete kanë rezultuar me dorëzimin e ofertave

8 aktivitete janë anuluar për arsye të ndryshme

14 aktivitete janë ende në proces, të inicuar në muajt e fundit të periudhës së monitorimit deri më 31 gusht 2024, dhe nuk ka të dhëna për numrin e ofertuesve pasi ato janë ende në proces e sipër.

Në vlerësimin e kësaj kërkesë, INPO u përqendrua në 53 aktivitetet e prokurimit që rezultuan me dorëzimin e ofertave, duke përjashtuar 8 aktivitete të prokurimit të anuluar dhe 14 aktivitete që kanë mbetur në vazhdim deri më 31 gusht 2024, pa arritur në fazën e dorëzimit të ofertave.

Për shkak se disa aktivitete të prokurimit fillojnë si proces i vetëm, por rezultojnë në kontrata të shumta për shkak të ndarjes në lote, INPO kreu një analizë të veçantë për të vlerësuar numrin e ofertuesve për çdo lot individual. Nga 53 aktivitete të prokurimit me oferta të dorëzuara, 6 janë ndarë në disa lote. Çdo lot është konsideruar si një kontratë e veçantë prokurimi dhe sipas vlerësimit të kërkesës 6 numri i ofertuesve është llogaritur për secilin lot. Kështu, këto 53 aktivitete të prokurimit në total rezultuan me dhënien e 72 kontratave. Në këto 72 kontrata, morën pjesë gjithsej 410 ofertues, duke rezultuar në një mesatare prej 5.69 ofertues për aktivitet/lot.

Sipas udhëzuesit të vlerësimit, nëse numri mesatar i ofertuesve është ndërmjet 2 dhe 5.99, Autoriteti Kontraktor, **Ministria e Infrastrukturës rezulton se përmbush pjesërisht Kërkesën 6.**

Kërkesa 7: Raportet Vjetore që Përfshijnë të Gjitha Prokurimet Publike të Kryera janë në Dispozicion të Publikut

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në kuadër të akteve nënligjore, konkretisht në nenin 16.3², mandaton përgatitjen e një raporti vjetor për kontratat publike të nënshkruara, duke obliguar çdo autoritet kontraktues që të hartojë një raport vjetor gjithëpërfshirës për çdo kontratë publike të nënshkruar në vitin paraprak fiskal. KRPP-ja ka miratuar Formularin B53 - Raport Vjetor për Kontratat Publike të Nënshkruara në kuadër të rregullores së saj. Megjithatë, edhe pse Ministria e Infrastrukturës e ka dorëzuar raportin në KRPP, ai nuk është publikuar në ueb faqen e Ministrisë dhe as në portalin e prokurimit elektronik. INPO e ka marrë raportin për kontratat e nënshkruara për vitin 2023 vetëm përmes një kërkesë për qasje në dokumente publike. Meqenëse Raporti Vjetor mbi Kontratat Publike të Nënshkruara nuk është i disponueshëm publikisht, **Ministria e Infrastrukturës nuk e ka përmbushur këtë kërkesë.**

Vlerësimi përfundimtar i kërkesave

Kërkesa	Vlerësimi përfundimtar
[Planet e përditësuara të prokurimit publik janë në dispozicion të publikut]	Përmbushur plotësisht
[Prokurimet publike janë nisur në përputhje me planin]	Përmbushur pjesërisht
[Ndryshimet në planet e prokurimit publik janë qartë të dukshme]	Përmbushur plotësisht
[Ndryshimet në planet e prokurimit publik arsyetohen siç duhet]	Përmbushur plotësisht
[Autoriteti kontraktues zhvillon procedura të hapura/konkurruese të prokurimit publik]	Përmbushur pjesërisht
[Numri mesatar i ofertuesve në procedurat e hapura/konkurruese]	Përmbushur pjesërisht
[Raportet vjetore që përfshijnë të gjitha prokurimet publike të kryera janë në dispozicion të publikut]	Nuk është përmbushur

2 Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Gjetet në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf.

III: Rekomandime për përmirësime

Bazuar në analizën e praktikave të prokurimit brenda Ministrisë së Infrastrukturës, ky seksion ofron rekomandime të synuara për të adresuar dobësitë e identifikuara dhe për të rritur efikasitetin dhe transparencën e përgjithshme të proceseve të prokurimit. Rekomandimet janë krijuar për të qenë specifike, të zbatueshme dhe të kufizuara në kohë për të siguruar zbatim efektiv dhe përmirësime të matshme. Çdo rekomandim u përgjigjet drejtpërdrejt çështjeve të përkrahura në analizë, me fokus në hapat praktik që ministria mund të ndër marrë në afat të shkurtër, afat të mesëm dhe afat të gjatë.

1. Publikimi i planeve të prokurimit në internet: Ministria e Infrastrukturës duhet të publikojë planet e saj të prokurimit në faqen e saj zyrtare. Ky hap do të rrisë transparencën dhe do të lehtësojë qasjen e publikut në informacionin e nevojshëm të prokurimit. Ky rekomandim është një ndërhyrje afatshkurtër dhe duhet të zbatohet menjëherë për të përmirësuar qasjen në informacion dhe angazhimin e palëve të interesuara.

2. Të përafrohen afatet e prokurimit me njësitë kërkuese: Ministria duhet të sigurojë që afatet e përcaktuara në planin e prokurimit të jenë të sinkronizuara me njësitë kërkuese. Kjo qasje do të ndihmojë në parandalimin e vonesave dhe do të sigurojë efikasitetin e përgjithshëm të procesit të prokurimit. Ky është një rekomandim afatmesëm, që kërkon një rishikim dhe rregullim të procedurave aktuale të planifikimit dhe koordinimit.

3. Justifikimi i aktiviteteve të paplanifikuara të prokurimit: Për çdo aktivitet të paplanifikuar të prokurimit, Ministria duhet të ofrojë një arsyetim të qartë. Kjo do të rrisë transparencën duke ofruar shpjegime të hollësishme për devijimet nga plani fillestar i prokurimit, duke ruajtur kështu besueshmërinë dhe integritetin e procesit të prokurimit. Ky rekomandim është i zbatueshëm si në ndërhyrjet afatshkurtra ashtu edhe në ato afatmesme dhe duhet të integrohet në procedurat standarde të veprimit.

4. Rritja e përdorimit të procedurave konkurruese: Ministria duhet të rrisë numrin e aktiviteteve të prokurimit të kryera përmes procedurave konkurruese. Procedurat e hapura dhe konkurruese nxisin transparencën dhe drejtësinë, duke siguruar që të gjitha palët e interesuara të kenë mundësi të barabarta. Ky rekomandim është një strategji afatmesme që përfshin rishikimin e praktikave të prokurimit për të favorizuar proceset konkurruese të ofertave.

5. Ngritja e numrit mesatar të ofertuesve: Ministria duhet të synojë të rrisë numrin mesatar të ofertuesve në çdo procedurë konkurruese në më shumë se gjashtë. Rritja e numrit të ofertuesve rrit konkurrencën, e cila mund të përmirësojë cilësinë e ofertave dhe potencialisht të çojë në çmime më të ulëta. Ky është një rekomandim afatmesëm dhe afatgjatë, që kërkon ndryshime në praktikën e prokurimit dhe përpjekje për të tërhequr më shumë ofertues.

6. Publikimi i raporteve vjetore të prokurimit: Ministria duhet të publikojë raportin vjetor për kontratat publike të nënshkruara në faqen e saj zyrtare dhe në portalin elektronik të prokurimit. Mundësimi i qasjes publike në këtë raport do të rrisë transparencën dhe llogaridhënien në procesin e prokurimit. Ky është një rekomandim afatshkurtër që duhet të zbatohet çdo vit për të siguruar qasje të vazhdueshme publike në të dhënat e prokurimit.

Shtojcat

Qasja e lirë në kërkesat për informacion

Institucioni	Data e dërgimit	Data e marrjes
Ministria e Infrastrukturës	24.06.2024	18.07.2024
Ministria e Infrastrukturës	08.07.2024	18.07.2024
Ministria e Infrastrukturës	18.07.2024	19.07.2024
Ministria e Infrastrukturës	06.09.2024	10.09.2024

Intervistat

Institucioni	Pozita	Data	Vendi
Ministria e Infrastrukturës	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	27.06.2024	Zyra e Ministrisë së Infrastrukturës

Burime të tjera

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës - Ky ligj përshkruan kornizën për proceset e prokurimit publik në Kosovë. Mund të qaset përmes <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.
- Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik - Kjo rregullore parashikon rregulla dhe procedura të hollësishme për prokurimin publik. Gjendet në https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf.
- Portali i Prokurimit Publik - Ky portal ofron burime dhe përditësime në lidhje me prokurimin publik në Kosovë. Mund të qaset në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=327>.
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Faqja zyrtare e Ministrisë, e cila ofron informacion mbi çështjet mjedisore dhe të infrastrukturës. Mund të qaset në <https://mmphi.rks-gov.net/Environment>.

